



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 8 të Udhëzimit Administrativ (MPB) Nr. 19/2015 për kushtet dhe procedurat e ndërrimit të emrit personal si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN E KËRKESAVE PËR NDËRRIMIN DHE KORIGJIMIN E EMRIT PERSONAL

Neni 1

Përbërja

Formohet Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për ndërrimin dhe korigjimin e emrit personal në përbërje si vijon:

1. Fauz Xhemajli, Shef i Sektorit të Gjendjes Civile, kryesues
2. Burim Gashi, Shef i Sektorit për Administratë të Përgjithshme, anëtar
3. Sedat Hoxha, Zyrtar i Gjendjes Civile, anëtar.

Neni 2

Detyrat dhe përgjegjësit e Komisionit

1. Komisioni ka detyrë dhe përgjegjësi të shqyrtoj kërkesat e palëve dhe të vendos për ndërrimin e emrit personal konform procedurave të parapara me dispozitat e Ligjit Nr.02/L-118 për emrin personal si dhe Udhëzimit Administrativ (MPB) për kushtet dhe procedurat e ndërrimit dhe korigjimit të emrit personal.
2. Komisioni për punën e vet mbanë procesverbal.
3. Pas miratimit nga Komisioni, vendimet i nënshkruan kryesuesi i Komisionit.

Neni 3

Hyrja në fuqi

1. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe me të njëjtin njoftohet kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.
2. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, shfuqizohet Vendimi 1Nr.201-58406 i datës 01.12.2015 si dhe Vendimi 1Nr.201.58406/2 i datës 14.07.2022.

1Nr. 112/02-40903

Lipjan, 02.08.2022

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti

